



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 90 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Investimet e Huaja.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të Dokumenteve Strategjike për vitin 2012**

1. Në planin e dokumenteve strategjike për vitin 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshihen këto dokumente Strategjike:
  - 1.1 Strategjia për decentralizimin e Shërbimeve Sociale 2013-2017;
  - 1.2 Strategjia e Rishikuar e Energjisë 2013-2022;
  - 1.3 Plani i Zbatimit të Strategjisë Minerare 2012-2014;
  - 1.4 Strategjia për kalim në Transmetim Digjital në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit për monitorimin e zbatimit të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr 03/L-188 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Emërohen anëtarët në Komisionin për Vlerësimin e Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale në këtë përbërje:
  - 1.1. Adnan Bozalija;
  - 1.2. Blerim Kamberi;
  - 1.3. Branislav Kostic;
  - 1.4. Hilmi Islami;
  - 1.5. Rrahman Ferizi;
  - 1.6. Bujar Rexhaj dhe
  - 1.7. Dashnor Nebiu.
2. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vite.
3. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë punët dhe detyrat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 64.2 të Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin në Vlerën e Shtuar, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. I propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës zgjatja e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor të vitit 2014.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me vlerësimin e efekteve buxhetore dhe ekonomike të ia përcjellë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Miratohen shpronësimet, për interes publik, të pronarëve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdare e të cilat ndodhen brenda Sektorit 7 Zonat Kadastrale Sllatinë e Madhe, Henc, Miradi e Epërme dhe Miradi e Poshtme, Komuna e Fushë Kosovës dhe Zonat Kadastrale Batushë dhe Preoc, Komuna e Graçanicës, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Kuvendet Komunale të Fushë Kosovës dhe Graçanicës në territorin e të cilave gjenden ngastrat kadastrale.
3. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës dhe Graçanicës, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
4. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.



5. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 si dhe Marrëveshjes Kornizë të Instrumentit për Para-anëtarësim në Kosovë (IPA), Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

**PËR SISTEMIMIN DHE PUNËSIMIN E BURSISTËVE**  
**“SKEMA E PROFESIONISTËVE TË RINJË”**

1. Qëllimi i këtij vendimi është sistemimi dhe punësimi në Qeverinë e Kosovës i bursistëve të Projektit të Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës “Skema e Profesionistëve të Rinj” (*Young Cell Scheme - YCS*).
2. Sistemimi i kandidatëve të YCS dhe punësimi i tyre 3 vjeçar në Shërbimin Civil të Kosovës është obligim që del nga kontratat e lidhura në mes të kandidatëve bursist të YCS, Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës si dhe Marrëveshjes së IPA.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike, që gjatë procesit të miratimit të përshkrimeve të vendeve të punës për pozitat profesionale dhe miratimit të kërkesave për publikim të konkurseve për plotësimin e këtyre vendeve të punës, paraprakisht të koordinohet me Ministrinë e Integritimit Evropian, si institucion përgjegjës për menaxhimin e Skemës “YCS”, dhe të kërkoj me shkrim pëlqimin e tyre.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian që të jap përgjigje në formë të shkruar brenda pesë (5) ditëve të punës prej marrjes së shkresës nga Ministria e Administratës Publike nëse për pozitën e lirë të caktuar ekzistojnë burime të mjaftueshme dhe adekuate njerëzore në kuadër të Skemës “YCS”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha Ministrinë dhe agjencitë vartëse të Qeverisë së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/94  
Datë: 10.10.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës së Kryeministrit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 300,000.00 euro si në vijim:
  - 1.1. Në kodin 10700 Kabineti i Kryeministrit, shuma prej 200,000.00 euro dhe
  - 1.2. Në kodin 10600 Zyra e Kryeministrit, shuma prej 100,000.00 euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimin ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet paparashikuara.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë